



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/ 200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tridhjetë e katër e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **31.01.2025**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Negidet Ramaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Nexhmedin Balaj AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 16. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 17. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 5. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 18. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 6. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 20. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 8. <u>Liridona Lajci Avdijaj LDK</u> | 21. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 9. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 23. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 11. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 24. <u>Djula Karisik, GIBI;</u> |
| 12. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> | |
| 13. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, Nënkryetari i komunës Ali Nimanaj, Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ OSBE, si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në <https://www.youtube.com/watch?v=wFBp8AAy3IU> "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.
Hap punimet për mbledhjen e tridhjetë e katër të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezent janë 24 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024,
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2024,
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSBB-së për vitin 2024,
6. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2024,
7. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit për vitin 2024,
8. Shqyrtimi i Raportit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2024,
9. Raporti Vjetor i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve- Istog,
10. Shqyrtimi i Raportit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026,
11. Raporti i punës së KRM Ambienti Njësia Operative Istog (janar-dhjetor)2024
12. Realizimi i planit Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe plani operacional 2024,
13. Raporti i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë,
14. Njoftimi me Raportin Vjetor për kontratat e nënshkruara publike,
15. Njoftimi me Raportin e punës së Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje,
16. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për rishqyrtimin e Vendimit 00 Nr.163/2024 për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025.
17. Rishqyrtimi i Rregullores 00 Nr. 189/2024 për Shitjen e Mallrave, Artikujve dhe shërbimeve tjera jashtë lokaleve afariste,
18. Plotësim -Ndryshimi i Rregullores 00 Nr. 177/2024 për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha,

19. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për Shfuqizimin e Vendimit 00 Nr. 186/2024 për themelimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit,
20. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit,
21. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit- e kemi një mbledhje të ngjeshur, tani duhet të shtohen edhe disa pika në bazë të kërkesës, kemi shkuar në ministri dhe pika 20 e rendit të ditës derivon që nuk e pranojnë komisionin, pra pika 19 duhet të shfuqizohet ai vendim, dhe për çdo pronë për ta dhënë në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit, e kemi për çdo pronë nga një komision. Kjo do ta ngarkoj sot rendin e ditës, ligji e thotë që brenda 30 ditëve duhet të rishqyrtohet dhe na humb afati ligjor, kështu që sot duhet të përfundohet kjo.

Pyetjes ekzekutivin dhe anëtarët e Kuvendit a kanë vërejtje apo plotësim rreth rendit të ditës që është i propozuar për ditën e sotme? Fjalën e ka Genc Ademaj.

Genc Ademaj- unë e kisha pasur një propozim që pika 18 e rendit të ditës 'Plotësim -Ndryshimi i Rregullores 00 Nr. 177/2024 për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha të hiqet nga rendi i ditës, në mbledhjen e kaluar në dhjetor, është miratuar, konfirmimi i ligjshmërisë është kthyer pozitiv, mirëpo bashkë me drejtorin e Bujqësisë e kemi bërë një kërkesë për një interpretim lidhur me një rekomandim që ka ardhur për me bërë plotësim-ndryshimin e Rregullores e që realisht është prapë në kundërshtim me ligjin që e ka lëshuar ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Na është rekomanduar që të përfshihen tri pika në Rregullore të cilat nuk janë më kompetencë e komunave por e Agjencionit Pyjor të Kosovës. Për këtë arsye unë kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, për shkak se rekomandimi i tyre nuk përket me Rregulloren tone dhe nuk është përgjegjësi e komunave.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Skender Hasangjekaj.

Skender Hasangjekaj- për shkaqe subjektive dhe anagazhime nuk kam arritur me kohë ta hartoj Planin e Punës së KKSB-së për vitin 2025. Konsultimet që i kam bërë me anëtarët e KKSB-së, kemi arritur ti bëjmë disa ndryshime në krahasim me Planin e Punës që ka qenë në vitin 2024. Andaj kisha kërkuar një mirëkuptim që sot ta trajtojmë Planin e Punës të KKSB-së për vitin 2025, sepse nëse shtyhet për mbledhjen e radhës i krijon vështirësi KKSB-së për ta arritur Planin e Punës gjatë vitit 2025.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush propozime fjalën e ka Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- ashtu siç e shpjegoi edhe kryesuesi, MAPL-ja e ka kthyer vendimin e komisionit vlerësues në rishqyrtim për shkak se kërkon që për 18 parcelat që i kemi vendos në vendimin për dhënie në shfrytëzim të pronave përmes shprehjes së interesit me e formuar për secilën parcelë me qenë vendimi i komisionit veçmas. Tash i bie shumë pika por janë teknike, neve nuk na ndalon ligji me i lënë anëtarët e njejtë të komisionit, por duhet për secilën parcelë me qenë vendimi i veçantë. Proceduralisht mundemi me e kaluar shpejt, anëtarët mundemi me i lënë të njejtë përveç këto të ekzekutivit që mundemi të bëjmë ndonjë ndryshim. Që keni nevojë ndonjë sqarim shtesë, urdhëroni.

Kryesuesi i Kuvendit- duhet ti propozosh drejtor të tetëmbëdhjetë pikat shtesë ashtu siç e kërkon ligji. Lexoj të tetëmbëdhjetë pikat se duhet të evidentohen.

Agon Dreshaj- Drejtori lexon 18 pikat e propozuara për rend dite.

Kryesuesi i Kuvendit- këto janë propozime ose pika të veçanta për rendin e dites për mbledhjen e sotme. Janë 18 pika që i propozoi drejtori që duhet të formohen 18 komisione veç e veç për secilën pronë. Për informimin e juaj e kemi pikën e 20 këtu, d.m.th e kemi paraparë, prej këtu do të fillojmë. Kemi biseduar me ministri edhe gojarisht, të gjitha të tjerat në lidhje me këto prona janë kthyer pozitivisht, përveç këtij komisioni. Gjithashtu kemi qenë me zyrtarin ligjor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për dy deponitë në një lloj mënyre krejt komplet na kanë thënë që është në rregull por na kanë kthyer, kemi shkuar jemi marrë vesh dhe na kanë treguar rrugën ta kalojmë në Kuvend që është me rëndësi për komunën tonë. Ne sot duhet t'i shqyrtojmë dhe propozoj këto dy pika të reja për rendin e ditës: Vendim për rishqyrtimin e vendimit 00 Nr 183/2024 i datës 27.12.2024 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e deponisë të materialeve inerte lokacioni në Tuqep dhe Vendim për rishqyrtimin e vendimit 00 Nr 184/2024 i datës 27.12.2024 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e deponisë transfer lokacioni në Tuqep. A ka edhe dikush diçka të shtoj. Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- pikërisht për pikën e 20-të edhe këto dyja propozoj që mos të përfshihen në rendin e ditës, propozojmë që të hiqet nga rendi i ditës që sot mos të diskutojmë dhe mos të marrim vendime për këtë pikë për shkak se është një çështje shumë e ndjeshme ne edhe më herët e kemi diskutuar këtë dhe i kemi ngritur shqetësimet tona d.m.th po bëhet fjalë për dhënien e pronave në shfrytëzim, pardje pasdite na ka ardhur materiali për këto 18 pika, dhe një raport i kryetarit me 96 faqe, Lëvizja Vetëvendosje propozon që për shkak se disa prej këtyre pronave për momentin janë të uzurpuara, pra me u diskutuar për to nuk bën, por të jepen në shfrytëzim po. Ne kërkojmë që pika 20 të hiqet nga rendi i ditës për sot, në qoftë se e kërkon koha mund ta bëjmë pas 4-5 ditësh që me pasur mundësi me i shqyrtuar secilën prone veç e veç.

Kryesuesi i Kuvendit- i nderuar Lista e pronave është miratuar në Kuvend. Është kthyer e ligjshme. Nuk kemi probleme me prona, kemi me komisionin vlerësues. Pronat janë në rregull. Për shkak të korrektësisë duhet të ju them që disa materiale janë vonuar që ne deri kur i kemi kryer vizitat nëpër ministri dhe deri kur na kanë kthyer përgjigjet adekuate, procedoni ose mos procedoni ne nuk kemi mundur që ta përcjellim materialin sepse një pjesë e materialit ka ardhur me vonesë. Ju kërkoj mirëkuptim. Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- më herët the me u përmbajtur diçka kështu, kemi shumë pika ne nuk mundemi me i bërë punët shkel e shko. Keni sjellë material si me pa dashur ta kryeni krejt planin e punës së Kuvendit për vitin 2025 sot.

Genc Ademaj- një sqarim profesor, ta kemi të qartë se për çfarë po diskutojmë. Jemi duke diskutuar për themelimin e komisionit, jo dhënie. Pronat që kanë me u dhënë, janë miratuar është vendimi i listës për të cilën është kthyer konfirmimi i ligjshmërisë pozitiv. Po flasim për themelimin e komisioneve për trajtim veçmas të secilës pronë, të cilin komision e kemi kryer edhe mbledhjen e kaluar e që është kthyer në rishqyrtim. Ai zyrtari që e ka aprovuar atë komisionin për dhënie e pronave bujqësore që ka qenë I përbërë edhe prej juve edhe prej ekzekutivi tash ka vendosur me e bërë për secilën pronë ka një komision veçmas. Te pjesa e materialeve të tjera, po rendi i ditës është voluminoz për arsye se kërkohet në muajin e parë pas përfundimit të vitit fiskal të bëhet raportimi i të gjitha planeve që janë miratuar më herët në Kuvend me qëllim që ta arrijmë prapë grantin e performancës.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- edhe njëherë ta sqarojmë. Lëvizja Vetëvendosje nuk është për me formuar komisione për prona që janë të uzurpuara. Së pari kur e votojmë këtu komisionin ne jemi për me i dhënë pronat në shfrytëzim. Dhe aty nuk ka më konkurrencë të drejtë kur dikush veç e ka mbjellë me grurë apo me kultura të tjera bujqësore. Kush do të aplikoj aty kur dikush e ka të mbjellur. Kush e fut vetën në problem edhe nëse ka ndonjë plan më të mirë se ai që e ka të uzurpuar. Ne duhet me i shikuar të gjitha pronat se nuk kemi pasur kohë, duhet me na dhënë kohë me shikuar se për cilën pronë duam të formojmë komision e për cilën jo.

Kryesuesi i Kuvendit- unë jam i obliguar është afati 30 ditë për rishqyrtim, vitin e kaluar me një komision tani në këtë vit nuk na kanë lejuar. Nuk ka diçka tjetër.

Florin Dreshaj- është kërkesë e jona me e hedh në votim që me e heq nga rendi i ditës?

Kryesuesi i Kuvendit- e kemi pikën e 18 që propozoi drejtori të hiqet nga rendi i ditës? Kush është të hiqet kjo pikë nga rendi i ditës?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 5 abstenime hiqet nga rendi ditës pika 18.

Kryesuesi i Kuvendit- e hedhim në votim propozimin e z.Skender Hasangjekaj nga drejtoria e Emergjencave që të hyn në rend dite 'Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2025. Kush është për?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 5 abstenime hyn në rend dite Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit- tani e hedh në votim propozimin e z. Florin Dreshaj që të hiqet nga rendi i ditës pika 20? Kush është për ?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 10 vota pro 12 kundër dhe 0 abstenime nuk kalon propozimi i z. Florin Dreshaj.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë tani me 18 pikat e propozuara nga drejtori për Gjeodezi dhe Kadaster, propozimi i parë, shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.1428-0 ZK Shushicë).

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 14 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime hyn në rend dite propozimi i parë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.1428-0 ZK Shushicë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e dytë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.1423-0 ZK Shushicë) e hedh në votim.

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i dytë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.1423-0 ZK Shushicë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e tretë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.1420-0 ZK Shushicë) e hedh në votim.

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i tretë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.1420-0 ZK Shushicë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e katërt të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.1424-0 ZK Shushicë) e hedh në votim.

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i katër i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.1424-0 ZK Shushicë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e pestë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.373-0 ZK Kërrninë) e hedh në votim.

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i pestë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.373-0 ZK Kërrninë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e gjashtë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.367-0 ZK Kërrninë) e hedh në votim.

Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 1 abstenime hyn në rend dite propozimi i katër i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.367-0 ZK Kërrninë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e shtatë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.368-0 ZK Kërrninë) e hedh në votim.

Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i shtatë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.368-0 ZK Kërrninë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e tetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.942-0 ZK Osojan) e hedh në votim.

Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i tetë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.942-0 ZK Osojan).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e nëntë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.369-0 ZK Kërrninë) e hedh në votim.

Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i nëntë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.369-0 ZK Kërrninë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e dhjetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.223-0 ZK Kërrninë) e hedh në votim.

Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i dhjetë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.223-0 ZK Kërrninë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.500-0 ZK Bellopojë) e hedh në votim.

Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i njëmbëdhjetë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.500-0 ZK Bellopojë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e dytëmbëdhjetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.499-0 ZK Bellopojë) e hedh në votim.

Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i trembëdhjetë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.499-0 ZK Bellopojë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.981-0 ZK Osojan) e hedh në votim.

Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i trembëdhjetë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.981-0 ZK Osojan).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e katërmëdhjetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.372-0 ZK Kërrninë) e hedh në votim.

Konstatohet që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i katërmëdhjetë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.372-0 ZK Kërrninë).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e pesëmbëdhjetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.982-0 ZK Osojan) e hedh në votim.

Konstatohet që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i pesëmbëdhjetë i drejtorit 'Shqyrtimi

dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.982-0 ZK Osojan).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.352-1 ZK Tuqep) e hedh në votim.

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i gjashtëmbëdhjetë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.352-1 ZK Tuqep).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e shtatëmbëdhjetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.540-0 ZK Veriq) e hedh në votim.

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i shtatëmbëdhjetë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.540-0 ZK Veriq).

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e tetëmbëdhjetë të propozuar, 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.541-0 ZK Veriq) e hedh në votim.

Konstatojmë që nga 16 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 16 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite propozimi i tetëmbëdhjetë i drejtorit 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit (Nr.541-0 ZK Veriq).

Hedh në votim edhe dy propozimet e mia që të hynë në rend dite është fjala për rishqyrtimin e vendimeve , propozimi i parë Propozim-Vendimi për rishqyrtimin e vendimit 00 Nr 183/2024 i datës 27.12.2024 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e deponisë të materialeve inerte lokacioni në Tuqep

Konstatojmë që nga 16 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 16 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite Propozim-Vendimi për rishqyrtimin e vendimit 00

Nr 183/2024 i datës 27.12.2024 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e deponisë të materialeve inerte lokacioni në Tuqep.

Dhe propozimi dytë Propozim-Vendimi për rishqyrtimin e vendimit 00 Nr 184/2024 i datës 27.12.2024 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e deponisë transfer lokacioni në Tuqep.

Konstatojmë që nga 16 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 16 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenime hyn në rend dite Propozim-Vendimi për rishqyrtimin e vendimit 00 Nr 184/2024 i datës 27.12.2024 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e deponisë transfer lokacioni në Tuqep.

Kryesuesi i Kuvendit- e hedh në votim rendin e ditës me të gjitha propozimet e reja që u futën në rend dite si dhe heqjen e një pike të rendit të ditës . Kush është që të procedojmë me këtë rend dite për mbledhjen e sotme?

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Në mbledhje mungojnë Arianit Selmanaj, Andi Xhuraj për shkaqe personale dhe Njomza Demaj për shkaqe shëndetësore.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? A ka dikush vërejtje apo sugjerime? Pasi që nuk ka diçka tjetër e hedh në votim kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- materialin e keni pasur a ka dikush diçka në lidhje me Raportin e punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024, pasi që jo, është veç njoftim, ju faleminderit!

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin rreth Raportit të Punës së Kryetarit, këtu është nënkryetari, a ka dikush diçka: pasi që jo. Ju falenderoj!

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka dikush diçka në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, pasi që jo vazhdojmë tutje.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit -fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2024.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! E hapi debatin a ka dikush diçka? Pasi që jo vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- jep një përmbledhje për të gjitha raportet.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën tjetër.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës, a ka dikush diçka. Fjalën e ka Agron Gashi.

